



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

-Numri i lëndës: 2019:080186
Datë: 15.02.2023
Numri i dokumentit: 03979574

Ac.nr.5394/19

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi, kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Hunaida Pasuli - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. O. nga fshati B., Komuna e G., të cilin e përfaqëson i autorizuari P. P., avokat në Gjakovë, kundër të paditurit N. L. nga fshati D., Komuna e Gj. të cilin e përfaqëson me autorizim I. D., avokat nga G., për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 120,200.00 euro, duke vepruar sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse të ushtruara kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.566/2010, të datës 22.08.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHEN pjesërisht si të themelta ankesat e paditësit M. O. nga fshati B., Komuna e Gj.dhe e të paditurit N. L. nga fshati D., Komuna e Gj..., NDRYSHOHET PJESERISHT Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.566/2010 të datës 22.08.2019, pika I e dispozitivit, që ka të bëjë me aprovimin e pjesërishtëm të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit material dhe jo material dhe atë sa i përket dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar dhe ushqimit të përforcuar, ashtu që tani kjo çështje gjykohet si në vijim: APROVOHET PJESËRISHT si e themeltë kërkesëpadia e paditësit M. O. nga fshati B., Komuna e Gj., dhe DETYROHET i padituri N.L. nga fshati D., Komuna e Gj.s që në emër të demit jo material t'ia kompensojë paditësit për dhimbje fizike shumën prej 7,500.00 Euro; për frikën e përjetuar shumën prej 6,500.00 Euro dhe për ushqimin e përforcuar shumën prej 1,000.00 Euro, me kamat prej 8% nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë (22.08.2019) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, nga shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar, REFUZOHET SI E PA BAZUAR.

II. APROVOHET pjesërisht si e themeltë ankesa e paditësit M. O. nga fshati B., Komuna e Gj., PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë Departamenti i Përgjithshëm,

C.nr.566/2010 të datës 22.08.2019, përkatësisht pika II e dispozitivit që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit ndaj të paditurit në emër të fitimit të humbur (rentës) nga data 19.01.2000 deri më datën 18.01.2013 në shumën prej 30,000.00 Euro, dhe lënda për këtë pjesë i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

III. REFUZOHEN pjesërisht si të pathemelta ankesat e paditësit M. O. nga fshati B., Komuna e Gj.. dhe e të paditurit N. L. nga fshati D., Komuna e Gj., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.566/2010, i datës 22.08.2019, në pikën I të dispozitivit që ka të bëjë me aprovimin e pjesërishtëm të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit jo material dhe material, dhe atë në emër të shëmtimit trupor, ndihmën e personit të tretë, shpenzimet e shërimit dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.566/2010 të datës 22.08.2019 në pjesën e I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit M.O. nga fshati B., Komuna e Gj.. dhe ka detyruar të paditurit N. L. nga fshati D., K. e Gj. që t'ia paguaj paditësit dëmin jo material dhe material dhe atë: për dhimbje fizike shumën prej 15,000.00 euro; për frikën e përjetuar shumën prej 12,000.00 euro, për shëmtim trupor shumën prej 5,000.00 euro; për ndihmën e huaj nga personi i tretë shumën prej 1,000.00 euro; për ushqim të përforcuar shumën prej 500,00 euro; respektivisht në shumën e përgjithshme 33,500.00 euro (tridhjetë e tre mijë e pesëqind euro) me kamatë prej 8% duke llogaritur nga data dita e precizimit të kërkesëpadisë me datën 17.04.2019 e deri në pagesën definitive si dhe ka OBLIGUAR të paditurin që t'ia kompensojë paditësit shpenzimet procedurale në shumë prej 1,750.00 euro, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmabrimin me dhunë. Në pikën II të dispozitivit pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit M. O. nga fshati B., Komuna e G., nga shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë: për dhimbje fizike shumën prej 23,000.00 euro; për frikën e përjetuar shumën prej 22,400.00 euro; për shëmtim trupor shumën prej 5,000.00 euro; për ndihmën e huaj nga personi i tretë shumën prej 800,00 euro; për ushqimin e përforcuar shumën prej 500,00 euro; në emër të rentës duke filluar nga data 19.01.2000 deri më 18.01.2013 në shumën prej 30,000.00 euro; për shpenzimet e shërimit shumën prej 5,000.00-euro e në shumë të përgjithshme prej 86,700.00 euro (tetëdhjetmijë e shtatëqind euro) e ka REFUZUAR SI TE PA BAZUAR.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, kanë paraqitur ankesë të dy palët ndërgjyqëse.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij është ankuar, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ta aprovoj ankesën e paditësit, ndërsa Aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj duke aprovuar kërkesëpadinë e precizuar sa i përket pjesës refuzuese si dhe rentës së përjetshme të precizuar si në kërkesëpadi duke filluar nga dita e shakatimit të lëndimit e deri në dalje në pension të paditësit.

Pala e paditur është ankuar për shkak të shkeljes së dispozitive të procedurës kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të aplikimit të gabuar të të drjetës materiale dhe për shkak të shpenzimeve të procedurës kontestimore, ndërsa ka kërkuar nga Gjykata e Apelit që ankesën si të tillë ta aprovoj, Aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj në tërësi e cështja të rigjykiehet nga Gjykata e Apelit meritorisht, ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar dhe kërkespadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar ose ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe lëndën ta kthejë në rivendosje.

I padituri ka ushtruar edhe përgjegje në ankesën e paditësit me propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzojë si të pa bazuar ankesën e paditësit.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, shqyrtimit dhe analizimit të provave dhe shkresave të lëndës, në mbështetje të nenit 194, 195, par.1, pika d) dhe e), në lidhje me nenin 200 dhe 201, pika b) dhe d) të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e palëve ndërgjyqëse janë pjesërisht të bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me padinë e parashtruar në datën 17.12.2010 në gjykatën e shkallës së parë dhe precizimin e kërkesëpadisë me datën 17.04.2019 ka kërkuar që të detyrohet i padituri t'ia kompensojë paditësin për dëmin material dhe jo material, në shumat e kërkuara (si në shkresa të lëndës), duke theksuar se i padituri me datë 29.08.2000, rreth orës 15:00 në fshatin D., K. e Gj., ka tentuar që ta privojë nga jeta B. Gj. nga Gj. duke venë në rrezik edhe jetën e paditësit në atë menyrë që nga dritarja e shtëpisë ka shtënë me pushkë automatike, e ka goditur në pjesë të ndryshme të trupit, duke e plagosur në këmbë dhe duke i shkaktuar plagë të rënda trupore të rrezikshme për jetën. Gjykata e Qarkut në Pejë me Aktgjykimin P.nr.75/01 të datës 04.04.2008, e ka shpallur fajtor të paditurin për veprën penale vrasje në tentativë.

Duke vepruar sipas kërkesë padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe pas administrimit të provave ka vendosur për aprovimin e pjesërishtëm të kërkesëpadisë sikurse në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, mes tjerash, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se gjykata ka vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë nga aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë P.nr.75/01 të datës 04.04.2008, ku është vërtetuar fakti se i akuzuari, këtu i padituri N.L. është shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 30, paragrafi 2, pika 2 e LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së, për shkak se me datë 19.08.2000 rreth orës 15:00/h në fshatin D., Komuna e Gj., me dashje për shkak të marrëdhënieve të këqija familjare ka tentuar ta privojë nga jeta B. Gj. nga Gj., dhe njëherit e ka venë në rrezik jetën e të dëmtuarit këtu paditësit M. O. nga fshati B., Komuna e Gj.. ashtu që i akuzuari këtu i padituri duke qenë i armatosur me pushkë automatike A4-47 me numër 4223695, nga dritarja e shtëpisë ka shtënë në drejtim të automobilin ku ka qenë i dëmtuari, këtu paditësi duke e plagosur rëndë në këmbë, me këtë rast i akuzuari këtu i padituri N. L. është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjet. Me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP.nr.506/08 të datës 15.04.2009 është

miratuar ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Pejë dhe është ndryshuar aktykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë P.nr.75/01 i datës 04.04.2008 vetëm përkitazi me vendimin për dënim duke e gjykuar të akuzuarin këtu të paditurin me 7 (shtatë) vite burgim. Ndërsa në bazë të ekspertizave mjekësore të hartuara nga eksperti i Ortopedisë dhe traumatologjisë Dr.Xh. S.- Ortoped-traumatolog dhe ekspertiza e ekspertit të psikiatrisë Dr. N.P. psikiatër, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit dhe ka vendosur lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmeve materiale dhe jo materiale, që kanë të bëjnë me pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë, nga të cilat është vërtetuar se paditësi si pasojë e plagosjes me armë zjarri ka pësuar lëndim të rëndë trupor. Kështu që në bazë nenit 154 të LMD-së (viti 1978), nenit 14 të LPK-së, nenit 200, nenit 185 të LMD-së (viti 1978) nenit 323 të LPK-së ka vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 452.2 të LPK-së (*më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktgjykimit të atakuar*).

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në pjesët në të cilat i njëjti është vërtetuar nga kjo gjykatë e shkallës së dytë, si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që në këto pjesë, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par. 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, as në lidhje me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, e as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë, përveç pjesës së ndryshuar dhe të prishur, për të cilën është ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale, përkatësisht nuk e ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, si pasojë e të cilave janë shkelur dispozitat e LPK-së, për çka edhe ato pjesë të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, është dashur të ndryshohen, përkatësisht të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, për pjesën e vërtetuar si në dispozitivin III të këtij Aktgjykimi. Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurit për kompensimin e dëmit e deri te rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit. Gjykata e Apelit, pas ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë, brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë nga ndërgjyqësit, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, në prani të faktit se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit nuk mund të vihet në dyshim me pretendimet ankimore të të paditurit, e në prani të faktit se me aktgjykim penal të formës së prerë i padituri është shpallur fajtor për veprën penale tentim vrasje ndaj paditësit, ndërsa si pasojë ky i fundit ka pësuar lëndime të rënda trupore, të cilat janë vërtetuar përmes ekspertizave mjekësore nga lëmija e ortopedisë dhe psikiatrisë.

Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në çështjen e paditësit, me zbatimin e nenit 185 dhe 200 të LMD-së, dhe nenit 22, 24, 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

e ka miratuar (*pjesërisht*) si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e dëmit, në shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur, pasi që ka vlerësuar drejtë se i padituri është përgjegjës për shpërblimin e dëmit paditësit.

Përveç kësaj, gjykata e shkallës së dytë e pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë që ka të bëjë me refuzimin e prapësimi të palës së paditur që ka të bëjë me parashkrimin e kërkesës së paditësit për kompensimin e dëmit. Kjo për faktin se dëmi në këtë rast është shkaktuar me vepër penale, për çka në këtë rast zbatohet neni 377 i LMD-së, i cili shprehimisht përcakton se: *“Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”*. Si rrjedhojë, meqenëse padia e paditësit është parashtruar në gjykatë me datë 17.12.2010, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AP.nr.506/08, është marr me datë 15.04.2009, atëherë rezulton se padia është parashtruar brenda afatit ligjor dhe nuk është parashkruar.

Gjykata e shkallës së dytë e pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizave të ekspertëve, që ndërlidhen me natyrën e lëndimeve të paditësit dhe frikën e përjetuar, pasi që rezulton se ky është përfundim i drejtë dhe i ligjshëm.

Në anën tjetër, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të bazuara pretendimet ankimore të të paditurit për aplikimin e gabuar të drejtës materiale për shumën e gjykuar për paditësin në raport me dëmin jo material për dhimbjet e përjetuara fizike dhe për frikën e përjetuar, nga arsyeja se shumata e gjykuar është e lartë dhe nuk i shkon përshtati synimeve dhe qëllimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Prandaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së dytë konform nenit 201 pika d) të LPK-së, e aprovoi pjesërisht ankesën e të paditurit, e ndryshoj aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë në pikën I të tij dhe gjykoi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se shumata e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material, përkatësisht për dhimbjet e përjetuara fizike dhe për frikën e përjetuar janë shumë të larta dhe nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Kosovës për këto forma të shpërblimit të dëmit dhe as në natyrën dhe llojin e të mirës së dëmtuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se tani shumata e gjykuar për paditësin si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi është adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 200 par.2 të LMD-së, të zbatuar për këtë rast dhe se kjo shumë përfaqëson një satisfaksion adekuat që i dëmtuari (në këtë rast paditësi) t'i përballojë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me nenin 200 par.2 të LMD-së përcaktohet se *“me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të, të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë

adekuat me natyrën e lëndimit, në rastin konkret paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore për shkak të kryerjes së veprës penale tentim vrasjes nga ana e të paditurit dhe me dhimbjet fizike të pësuarra dhe frikën e përjetuar, ashtu që ky kompensim të përfaqësoj një lehtësim në përbalimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësi i ka pësuar në sulmin e ndodhur me datë 29.08.2000, e në të njëjtën kohë ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për atë sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit.

Gjykatës së Apelit i ka rezultuar i bazuar pretendimi i paditësit për aplikim të gabuar të së drejtës materiale për kategorinë e dëmit material në emër të ushqimit të përforcuar, për arsye se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar 16 muaj, vërtetuar nga ekspertiza mjekësore, ndërsa për këtë gjykata e shkallës së parë ia ka njohur paditësit shumën prej 500.00 Euro, e cila për Gjykatën e Apelit është shumë e vogël dhe nuk i shkon për shtati synimi të shpërbimit të dëmit dhe tani shuma e gjykuar si në dispozitivin I të këtij Aktgjykimi është adekuate dhe sa do pak mbulon shpenzimet për ushqim të përforcuar të paditësit për periudhën 16 mujore që ka qenë e nevojshme për rikuperimin e tij. Forma të tilla të dëmit, është e vështirë, e pothuajse e pamundur, që të vërtetohen me prova konkrete, por praktika e Gjykatave të Kosovës, njeh forma të tilla të kompensimit, sa herë që konstatohet nevoja për to. Kështu, meqë në këtë rast, në ekspertizë mjekësore është konstatuar se pala e dëmtuar ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar për periudhën 16 mujore, atëherë vërtetohet se paditësit i takon e drejta në kompensim për këtë formë të dëmit, në lartësinë e gjykuar si në dispozitivin I të këtij Aktgjykimi.

Shumat e gjykuara sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi janë gjykuar me kamatë ligjore prej 8% nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë (22.08.2019) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm konform nenit 382 të LMD-ës.

Si rrjedhojë e të cekurave më lartë, Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar si të pathemelta ankesat e palëve ndërgjyqëse, duke e vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.566/20110, të datës 22.08.2019, në pikën I të dispozitivit që ka të bëjë me aprovimin e pjesërisht të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit jo material dhe material, dhe atë në emër të shëmtimit trupor, ndihmën e personit të tretë, shpenzimet e shërimit dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e Apelit vendosi sikurse në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, për kompensimin e dëmit jo material dhe material. Kjo për faktin se një e drejtë e tillë i takon në bazë të nenit 185 dhe 200 të LMD-së, ndërsa në lidhje me lartësinë e saj gjykata e shkallës së parë me të drejtë është bazuar në ekspertizën e ekspertëve mjekësor dhe ka gjykuar shumë të përshtatshme dhe në përputhje me të mirën e cënuar.

Në anën tjetër, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar pjesërisht si të bazuara pretendimet ankimore të paditësit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, lidhur me pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit që ka

të bëjë me pjesën e gjykuar për dëmin material në emër të fitimit të humbur – rentës dhe pikën, për të cilat Gjykata e Apelit vlerësoi se duhet të aprovohet ankesa e paditësit, ashtu që aktgjykimi i atakuar të priset dhe për këtë pjesë të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Në këtë drejtim, është vlerësim i kësaj gjykate se edhe për këtë kategori të dëmit material, paditësit i takon e drejta e kompensimit sipas dispozitave përkatëse të LMD-së dhe përgjegjëse për të bërë këtë kompensim është këtu i padituri dhe atë për arsyet e cekura më lartë. Mirëpo, për shkak të paqartësive në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilit i kanë paraprirë edhe mungesat dhe jo sqarimi i duhur i periudhës dhe shumave të cilat i takojnë këtu paditësit në emër të formave të dëmit të cekura më lartë, ku në rastin konkret nuk është nxjerrë një ekspertizë nga lëmija e mjekësisë së punës për të vërtetuar shkallën e paaftësisë për punë dhe ekspertiza e aktuaristikës, e njëjta nuk ishte e mundur të ndryshohet nga gjykata e shkallës së dytë, por është dashur të prisen dhe ti kthehen në rigjykim gjykatës së shkallës së parë. Meqenëse në rastin konkret kemi skaktim të dëmit me vepër penale, atëherë gjykata e shkallës së parë pa nxjerrjes së provave si më lartë, duhet të llogaritë parashkrimin e të drejtës bazuar në dispozitën e nenit 377 të LMD-ës, e cila parasheh “*Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale. Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale passjell edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit. E njëjta gjë vlen edhe për ngecjen e parashkrimit*“. Në raste se vërtetohet paaftësia punuese, më pastaj të vërtetohet se gjatë asaj periudhe sa ekziston paaftësia punuese ka fitim të humbur tek paditësi apo jo, ka realizuar të ardhura financiare si më parë apo jo.

Përveç këtyre paqartësive, edhe llogaritja e shumës së kapitalizuar për periudhën 19.01.2000 deri me datën 18.01.2013, të cilën pastaj gjykata e shkallës së parë e ka gjykuar në pikën II, është plotësisht e paqartë dhe jo e argumentuar, e që bie në kundërshtim edhe me vet dispozitat e LMD-së, përkatësisht nenit 188, duke mos vërtetuar lartësinë e saj përmes ekspertizës nga lëmija e mjekësisë së punës dhe ajo aktuaristike. Si rrjedhojë, për shkak të këtyre paqartësive dhe mangësive në dispozitiv dhe arsyetim të aktgjykimit të atakuar (*të hartuara në kundërshtim me nenin 160 parag. 3 dhe 4 të LPK-së*), të cilat drejtëpërsëdrejti ndikojnë edhe në përshtatshmërinë për përmbarrim të të njëjtit, ka bërë që kjo pjesë e dispozitivit të mos mundet të ndryshohet, por të priset dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykatës së Apelit i ka rezultuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e cekur më lartë është nxjerrë duke e vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendjen faktike, si rezultat i së cilës edhe është zbatuar gabimisht e drejta materiale. Kjo për faktin se për zvogëlimin të aftësisë për punë të paditësit nuk është nxjerrë ekspertiza nga lëmija e punës, apo eventualisht në rastet më të ndërlikuara nga Instituti i Mjekësisë së Punës, ashtu siç është paraparë me nenin 358 parag.4 të LPK-së.

Si rezultat i mangësive të cekura më lartë, tani për tani nuk mund të qëndrojë vendimi i gjykatës së shkallës së parë sa i përket fitimit të humbur për paditësin, për arsye se nuk është vlerësuar aftësia për punë e paditësit përmes ekspertizës profesionale nga eksperti mjekësor i

lëmisë së punës. Në këtë mënyrë, fillimisht është dashur të sigurohen të dhënat e cekura më lartë nga pala paditëse, e pastaj nëse rezulton se paditësi ka realizuar, apo është duke realizuar ndonjë të ardhur financiare si rezultat i lëndimit të tij, atëherë të njëjtat do duhej të përfshiheshin në ekspertizë, duke u zbritur të njëjtat nga shuma e përgjithshme dhe mujore, të cilat do ti takonin paditësit për këtë formë të dëmit.

Mirëpo, për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e cekur më lartë, por është dashur që të priset pjesërisht aktgjykimi i atakuar dhe lënda për pjesën e kompensimit të dëmit material në emër të fitimit të humbur-rentës, të kthehet në rigjykim dhe vendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Andaj, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, t'i eliminojë shkeljet e sipër theksuara, ashtu që për vërtetimin e lartësisë së zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm punues tek paditësi, të caktoj kryerjen e ekspertizës përkatëse profesionale dhe si ekspert të caktojë ekspertin mjekësor të lëmisë së punës, apo eventualisht Institutin e Mjekësisë së Punës (*varësisht prej propozimit të palëve ndërgjyqëse*), ndërsa më pas të njëjtat të ftohen në shqyrtimin kryesor, që të arsyetojë të gjeturat e ekspertizës dhe të përgjigjet në pyetje eventuale të palëve ndërgjyqëse, ndërsa varësisht nga të gjeturat e kësaj ekspertize të kërkohet nga eksperti financiar (aktuaristikës) që t'i saktësojë shumat të cilat do ti takonin paditësit për këtë formë të dëmit, përfshirë këtu shumën e arritur për pagesë.

Në fund udhëzohet gjykata e shkallës së parë që pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, të vërtetoj gjendjen faktike dhe të vendos për pjesën e kërkesëpadisë së paditësit në bazë të ligjit, ndërsa me rastin e hartimit të aktgjykimit të ketë parasysh dhe zbatojë dispozitat e nenit 160 parag.3, 4 dhe 5 të LPK-së.

Gjykata e Apelit ka vërtetur edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, me arsyetim se i njejtë është nxjerrë bazuar në nenin 452.2 të LPK-ës dhe Tarifën e Odës së Avokatëve.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të palës së paditur, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë, në pjesët e vërtetuara të aktgjykimit të atakuar, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, përveç pjesës së ndryshuar dhe prishur. Andaj, në mbështetje të dispozitave të neneve 194 dhe 195, pikat c) d) dhe e), lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5394/19, datë 07.02.2023

Numri i lëndës: 2019:080186
Datë: 15.02.2023
Numri i dokumentit: 03979574

Kryetari i kolegjit,
Ardian Ajvazi